

20090711245

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA LIDHUR ME PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN
E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore me hua në shumë prej 18.900.000 euro, dedikuar për realizimin e Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji verifikohen me Marrëveshjen për hua për Projektin për përmirësimin e shërbimeve komunale, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 të këtij ligji është 13 vjet, me grejs periudhë të kyçur prej 5 vjetësh.

Shkalla e kamatës është LIBOR gjashtëmujor me interval variabil.

Në ditën e tërheqjes parë të mjeteve nga huaja, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore provizion të njëfishtë në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Huaja do të paguhet në 16 anuitete gjysmëvjetore secili në shumë prej 6.25% nga shuma e huas. Pagesa do të bëhet në çdo të 15-in shkurt dhe të 15-in gusht, duke filluar nga 15 gushti 2014 deri më 15 shkurt 2022.

Neni 4

Shfrytëzues të mjeteve të huas nga neni 1 të këtij ligji janë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, ndërmarrjet publike që janë themeluar nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, e që i plotësojnë kushtet për huamarrje në pajtim me Ligjin për borxh publik dhe me Ligjin për financimin e njëjësive të vetadministrimit lokal.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shfrytëzuesve të mjeteve të huas nga neni 4 i këtij ligji, Ministria e Financave do të lidhë marrëveshje të veçanta për hua.

Neni 6

Me shfrytëzuesit e mjeteve të huas nga neni 4 të këtij ligji, të cilët do t'i plotësojnë kushtet për marrjen e grantit në pajtim me Marrëveshjen për hua nga neni 2 të këtij ligji, Ministria e Financave do të lidhë marrëveshje të veçanta për grant.

Neni 7

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 të këtij ligji do ta paguajë nga mjetet që do të grumbullohen me pagimin e mjeteve të huazuara nga shfrytëzuesit e mjeteve të huas nga neni 4 të këtij ligji në pajtim me marrëveshjet e veçanta për hua nga neni 5 të këtij ligji dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.